



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 121/21) dhe nenit 28, paragrafit (9) dhe nenit 171 nënparagrafit (3) të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe Sistemeve të Pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për pozicionet nga të cilat përbëhet kapitali fillestar dhe mjetet vetanake të institucionit pagesor dhe institucionit të parasë elektronike, si dhe llojin, përmbajtjen dhe mënyrën e paraqitjes së raporteve për mjetet vetanake

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohen pozicionet që përbëjnë kapitalin fillestar dhe mjetet vetanake të institucionit pagesor dhe institucionit të parasë elektronike, si dhe llojin, përmbajtjen dhe mënyrën e dorëzimit të raporteve për mjetet vetanake në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: Banka Popullore).

2. Për nevojat e këtij vendimi, me termin institucion nënkuptohet institucioni pagesor dhe institucioni për para elektronike.

3. Në rastet kur institucioni i nënshtrohet mbikëqyrjes së konsoliduar dhe përgatit raporte financiare të konsoliduara për grupin, ai është i detyruar të përcaktojë mjetet vetanake në bazë individuale dhe të konsoliduar.

II. PËRFKUFIZIME

4. Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë vendim e kanë kuptimin si vijon:

4.1. **"Mjete jomateriale"** janë mjetet që lidhen me themelimin, licencat, patentat, koncesionet dhe shenjat mbrojtëse (përfshirë parakontratat për përvetësimin/përdorimin e tyre) dhe gudvillin. Mbështetja softuerike (angl. software) ose mbështetja softuerike në zhvillim nuk konsiderohen si mjete jo-materiale. Mjetet jo-materiale paraqiten në shumën neto, të reduktuara me shumën e zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimi;

4.2. **"Person nga sektori financiar"** është person juridik me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë saj, i cili është bankë ose institucion financiar jobankar.

4.3. "Fitim rrjedhës" ose "humbje rrjedhëse" është fitim ose humbje në bilancin e të ardhurave të institucionit, i arritur gjatë një periudhe kohore më të shkurtër se një vit kalendarik dhe përpara se të merret vendimi për konfirmimin e rezultatit financiar për periudhën nga bordi i aksionarëve ose mbledhja e bashkëpunëtorëve ose e një organi tjetër përkatës të institucionit.

4.4. "Fitim në fund të vitit" ose "humbje në fund të vitit" është fitimi ose humbja nga bilanci i të ardhurave të institucionit, i realizuar gjatë një viti kalendarik dhe para se të merret vendimi për të konfirmuar rezultatin financiar për vitin nga bordi i aksionarëve ose mbledhja e bashkëpunëtorëve ose një organi tjetër përkatës të institucionit.

4.5. "Fitimi i disponueshëm për shpërndarje" përfshin shumën e fitimit pas tatimit, të konfirmuar nga bordi i aksionarëve ose nga mbledhja e bashkëpunëtorëve ose organit tjetër përkatës të institucionit ose shumën e fitimit rrjedhës, të cilat plotësojnë kushtet për shpërndarjen e dividendit ose pagesën e avans-dividentit, në pajtim me ligjin.

5. Për termet të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë vendim vlen kuptimi i përcaktuar me Ligjin e Shërbimeve të Pagesave dhe Sistemeve të Pagesave.

III. KAPITALI FILLESTAR

6. Kapitali fillestar i institucionit përbëhet nga pozicionet e kapitalit bazë nga pika 13), nënpika 13.1) i këtij vendimi.

IV. MJETE VETANAKE

7. Mjetet vetanake të institucionit përfaqësojnë shumën e kapitalit bazë, të llogaritur në pajtim me kreun V nga ky vendim dhe kapitalit shtesë, i llogaritur në pajtim me kreun VI të këtij vendimi, duke marrë parasysh zbatimin e dispozitave të kreut VII të këtij vendimi.

8. Shuma e kapitalit shtesë të institucionit përfshihet në përbërjen e mjeteve vetanake nga pika 7) të këtij vendimi vetëm në një shumë që është e barabartë ose më e vogël se një e treta e kapitalit bazë të institucionit.

9. Institucioni është i detyruar të përcaktojë vlerën e pozicioneve të përdorura në përcaktimin e mjeteve vetanake në pajtim me standardet e kontabilitetit në fuqi, si në njohjen fillestare të këtyre pozicioneve ashtu edhe në matjen e mëvonshme, si dhe të dokumentojë këto pozicione dhe ndryshimet e tyre në të dhënat e tij kontabël dhe librat tregtarë.

10. Institucioni nuk mund të përfshijë pozicione që nuk plotësojnë kushtet e këtij vendimi në përcaktimin e mjeteve vetanake.

11. Nëse Banka Popullore konstaton se institucioni gjatë përcaktimit të mjeteve vetanake ka përfshirë disa pozicione që nuk i plotësojnë ose kanë pushuar së përmbushuri kushtet e këtij vendimi, ose që ka përfshirë pozicionet në një pjesë të papërshtatshme të mjeteve vetanake, do të udhëzojë institucionin që të përjashtojë pozicione të tilla gjatë përcaktimit të mjeteve vetanake, domethënë t'i përfshijë ato në pjesën përkatëse të mjeteve vetanake.

Institucioni me rastin e përcaktimit të mjeteve vetanake, mund t'i ripërfshijë pozicionet të cilat janë përjashtuar në pajtim me paragrafin (1) të kësaj pike, vetëm pasi t'i plotësojë kushtet e nevojshme të këtij vendimi dhe pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore.

V. KAPITALI BAZË

12. Kapitali bazë i institucionit fitohet kur përmbledhja e pozicioneve nga pika 13) e këtij vendimi do të zvogëlohet për përmbledhjen e artikujve të larguar nga pika 15) e këtij vendimi.

13. Në kapitalin bazë të institucioneve përfshihen:

13.1. Aksionet ose kontributet në institucion, të cilat:

- paguhen plotësisht me para në dorë, pas çka institucioni nuk mund të financojë blerjen e tyre, të drejtpërdrejt ose të tërthortë;
- i përmbushin rregulloret në fuqi të kontabilitetit dhe standardet në fuqi të kontabilitetit për të përfituar trajtimin e kapitalit aksionar, respektivisht të kontributeve;
- janë në dispozicion të plotë dhe të pakufizuar për të mbuluar humbjet;
- në mënyrë të pakushtëzuar janë të pakthyeshme dhe nuk mund të blihen, të shlyhen, pra nuk mund të ulet vlera e tyre, me përjashtim të rastit të falimentimit ose likuidimit të institucionit ose pas marrjes së miratimit nga Banka Popullore, sipas pikës 25) të këtij vendimi;
- në rast falimentimi ose likuidimi të institucionit, ato paguhen të fundit pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të tjera të institucionit;
- nuk ekziston obligim i detyrueshëm për të paguar dividendin, pra institucioni ka të drejtë të mos paguajë dividend ose ta kufizojë pagesën e tij, pa e konsideruar atë si pamundësi e institucionit për t'i përmbushur detyrimet e tij. Pagesa e dividendit bëhet vetëm nga fitimi i disponueshëm për shpërndarje dhe nuk ka përparësi në pagesën e dividendit.

13.2. Premia nga shitja e aksioneve ose kontributeve nga nënpika 13.1) e kësaj pike;

13.3. Rezerva e përgjithshme e detyrueshme (fondi rezervë i përgjithshëm);

13.4. Fitimi i mbajtur i pashpërndarë që nuk rëndohet me asnjë detyrim të ardhshëm, i cili shënohet në bilancin e institucionit dhe vërtetohet me vendim të bordit të aksionarëve ose mbledhjes së bashkëpunëtorëve. Vendimi duhet të përmbajë dispozitë që përcakton se fitimi i mbajtur nuk do të jetë i disponueshëm për pagesën e dividendëve në të ardhmen. Në këtë pozicion përfshihet edhe humbja e përmbledhur nga vitet e mëparshme, me parashenjë negative;

13.5. Fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit që plotëson kushtet e pikës 14) të këtij vendimi; dhe

13.6. Fitimi ose humbja e përgjithshme që i përfshin fitimet dhe humbjet e tjera që nuk janë paraqitur në bilancin e të ardhurave të institucionit.

Pozicionet nga nënpikat 13.4), 13.5) dhe 13.6) të kësaj pike duhet të jenë plotësisht dhe menjëherë në dispozicion për të mbuluar rreziqet dhe humbjet gjatë funksionimit të institucionit.

14. Fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit mund të përfshihet në përlogaritjen e kapitalit bazë të institucionit vetëm në bazë të pëlqimit të marrë nga Banka Popullore.

Banka Popullore do ta lëshojë pëlqimin nga paragrafi (1) i kësaj pike nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- shuma e fitimit rrjedhës ose fitimi në fund të vitit konfirmohet nga një shoqëri për revidim;
- shuma e fitimit rrjedhës ose fitimit në fund të vitit zvogëlohet me çdo pagesë të bazuar në dividendë, taksa ose detyrime të tjera të ngjashme që paguhen nga fitimi;
- organi kompetent i institucionit ka marrë vendim që përcakton se fitimi rrjedhës ose fitimi në fund të vitit nuk mund të përdoret për pagesën e dividendit.

Për vërtetimin e kushtit nga paragrafi (2), nënparagrafi (1) i kësaj pike, institucioni është i detyruar të dorëzojë:

- për fitimin në fund të vitit - raport mbi revizionin e kryer, i përgatitur në pajtueshmëri me rregulloret e revizionit, ose letër nga revizori se revizioni i raporteve financiare vjetore është në vazhdim e sipër, por revizori nuk ka ardhur deri te informacionet për të cilatraporti përfundimtar do të përmbante mendim të kualifikuar;
- për fitimin rrjedhës - raport për revizionin e kryer ose raport mbi verifikimin e informacioneve mesperiodeke financiare të përpunuara në pajtim me rregulloret e revizionit, ose letër nga revizori që revizioni i raporteve financiare është në vazhdim e sipër, por revizioni nuk ka ardhur në ndonjë dijeni për çka raporti përfundimtar do të përmbante mendim të kualifikuar.

Për vërtetimin e kushtit nga paragrafi (2), nënparagrafi (2) i kësaj pike, institucioni është i detyruar të dorëzojë:

- deklaratë të nënshkruar nga personi kompetent përkatës në institucion që të ardhurat dhe shpenzimet janë të paraqitura në bilancin e suksesit në pajtim me rregulloret e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit;
- bilanci i suksesit i nënshkruar nga drejtuesi, anëtarët e bordit drejtues, anëtarët ekzekutivë të bordit të drejtorëve ose autoritet tjetër përkatës të institucionit.

Banka Popullore vendos për kërkesën e paraqitur për dhënien e pëlqimit nga paragrafi (1) i kësaj pike, në afat prej 30 ditësh pas plotësimit të dokumentacionit që vërteton kushtet e kësaj pike.

Shuma e fitimit rrjedhës për të cilën është marrë pëlqimi nga paragrafi (1) i kësaj pike mund të përfshihet në përlogaritjen e kapitalit bazë në periudhat vijuese të vitit kalendarik aktual, vetëm nëse fitimi është arritur deri në datën për të cilën kapitali bazë përcaktohet se është më i madh se shuma e fitimit rrjedhës për të cilin është marrë pëlqim nga Banka Popullore.

15. Kapitali shtesë reduktohet nga artikujt e mëposhtëm të larguar :

15.1. Humbje në fund të vitit ose humbje rrjedhëse;

15.2. Aktivitet jo-materiale. Shuma e artikujve të zbritshëm zvogëlohet nga detyrimet tatimore të shtyra që do të shuheshin nëse mjetet jo-materiale do të zhvlerësoheshin ose gregjistroheshin, në pajtim me rregulloret e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit. Shuma e artikujve të zbritshëm rritet nga gudvilli nga investimet e rëndësishme të institucionit;

15.3. Shuma e investimeve direkte dhe indirekte në instrumentet e kapitalit vetanak nga kapitali bazë, duke përfshirë instrumentet kapitale për të cilat institucioni ka detyrim kontraktual për të blerë;

15.4. Shuma e investimeve direkte dhe indirekte në instrumente kapitale nga kapitali bazë i personave nga sektori financiar, me përjashtim të atyre të mbajtura deri në pesë ditë. Shuma e artikujve të zbritshëm është e barabartë me pozicionin afatgjatë bruto të institucionit në instrumentet kapitale nga kapitali bazë i këtyre personave;

15.5. Shuma e artikujve të zbritshëm nga kapitali shtesë nga pika 21) e këtij vendimi, e cila tejkalon shumën totale të kapitalit shtesë nga pika 17) e këtij vendimi.

15.6. Investimet në institucionet jofinanciare, ku nuk merren parasysh investimet që mbahen deri në pesë ditë, si dhe letrat me vlerë që paraqiten emër të institucionit, por për llogari të subjekteve të tjera.

VI. KAPITALI SHITESË

16. Kapitali shtesë i institucionit fitohet kur shuma e pozicioneve nga pika 17) nga ky vendim do të reduktohet me artikujt e zbritshëm nga pika 21) të këtij vendimi.

17. Kapitali shtesë i institucionit përfshin pozicionet e mëposhtme:

- instrumentet kapitale që plotësojnë kushtet nga pika 18) e këtij vendimi;
- instrumentet kapitale që plotësojnë kushtet e nga pika 19) e këtij, dhe
- preminë nga shitja e instrumenteve nga nënpika 1) e kësaj pike.

18. Instrumentet kapitale mund të jenë pjesë e kapitalit shtesë nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme:

18.1. Janë të lëshuara dhe plotësisht të paguara, ku institucioni nuk financon blerjen e tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, dhe nuk blihen nga institucioni, filiali i tij ose personi në të cilin institucioni ka pjesëmarrje;

18.2. Detyrimet e bazuara në këto instrumente janë plotësisht në varësi të detyrimeve ndaj kreditorëve të tjerë të institucionit, në rast falimentimi ose likuidimi të institucionit;

18.3. Kanë afat maturimi prej të paktën pesë vitesh;

18.4. Mund të riblihen ose shlyhen nga institucioni para afatit të maturimit vetëm pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore, në pajtim me pikën 25) të këtij vendimi ose në rast falimentimi ose likuidimi të institucionit;

18.5. Në rastet kur shuma e mjeteve vetanake është ulur nën shumën e përcaktuar me Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave, institucioni

anulon detyrimisht pagesën e kompensimit për periudhë të pacaktuar dhe në bazë jokumulative dhe ka të drejtë të përdorë kompensimin e papaguar për përmbushjen e detyrimeve të tij;

18.6. Nuk merren parasysh gjatë përcaktimit nëse janë plotësuar kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit, në pajtim me ligjin;

18.7. Instrumenti nuk duhet të ketë karakteristika që mund të vështirësojnë rikapitalizimin e institucionit.

19. Kreditë e varura që plotësojnë kushtet e mëposhtme mund të jenë pjesë e kapitalit shtesë:

19.1. Janë plotësuar siç duhet kushtet nga pika 18), nënpikat 18.2) 18.4), 18.6) dhe 18.7) të këtij vendimi;

19.2. I miratohen institucionit, me çka institucioni nuk financon miratimin e tyre dhe nuk miratohen nga filiali i institucionit ose nga personi në të cilin institucioni ka pjesëmarrje;

19.3. Kanë afat maturimi prej të paktën pesë vitesh.

20. Shuma e pozicioneve nga pikat 18) dhe 19) nga ky vendim që përfshihet në llogaritjen e kapitalit shtesë të institucionit gjatë pesë viteve të fundit deri në maturimin e tyre, është produkt i:

- shumës nominale të pozicionit në ditën e parë të pesë viteve të fundit deri në datën e maturimit kontraktual;
- numrit të ditëve kalendarike të mbetura nga maturimi kontraktual i pozicionit, pjesëtuar me numrin total të ditëve kalendarike në periudhën e pesë viteve të fundit.

21. Kapitali shtesë reduktohet nga artikujt e zbritshëm të mëposhtëm:

21.1. Shuma e investimeve direkte dhe indirekte në instrumente vetanake nga kapitali shtesë, duke përfshirë instrumentet për të cilat institucioni ka detyrim kontraktual për të blerë;

21.2. Shuma e investimeve direkte dhe indirekte në pozicione nga kapitali shtesë i personave nga sektori financiar, me përjashtim të atyre të mbajtura deri në pesë ditë. Shuma e artikujve të zbritshëm është e barabartë me pozicionin afatgjatë bruto të institucionit në instrumentet kapitale nga kapitali shtesë i këtyre personave.

VII. DISPOZITA TË TJERA

22. Para se të përfshihen pozicionet nga pikat 18) dhe 19) nga ky vendim në llogaritjen e mjeteve vetanake, institucioni është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore për kushtet në të cilat janë krijuar dhe të paraqesë dokumentacionin nga i cili do të mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë vendim për pozicionin përkatës, të paktën 30 ditë para synimit për përfshirjen e këtyre pozicioneve në llogaritjen e mjeteve të vetanake. Përveç kësaj, institucioni ofron edhe:

- llogaritjen e nivelit të mjeteve vetanake dhe pas përfshirjes së këtyre pozicioneve në llogaritjen e mjeteve vetanake me gjendjen e datës së raportimit;
- projekson të të ardhurave dhe shpenzimeve të institucionit, në të cilin merret parasysh efekti i përdorimit të pozicioneve, të paktën për tre vitet e ardhshme.

23. Kompensimi që u paguhet pozicioneve të kapitalit bazë dhe kapitalit shtesë mund të jetë në formë parash ose në formën e një instrumenti që mund të jetë pjesë e mjeteve vetanake të institucionit.

24. Në artikujt e zbritshëm nga pika 15, nënpikat 15.3) dhe 15.4) dhe pika 21), nënpikat 21.1) dhe 21.2) nga ky vendim, institucioni përfshin vetëm investime direkte dhe indirekte në pozicione të personave nga sektori financiar, të cilët, në pajtim me rregulloret që rregullojnë funksionimin e këtyre personave, kanë trajtimin e kapitalit rregullator.

Institucioni i shpërndan pozicionet nga paragrafi (1) i kësaj pike në artikujt të zbritshëm nga kapitali bazë ose nga kapitali shtesë, duke marrë parasysh cilësinë e tyre, të përcaktuar në rregulloren përkatëse që rregullon veprimtarinë e këtyre personave.

Nëse në bazë të rregullores që rregullon punën e personave nga sektori financiar nuk mund të bëhet ndarja nga paragrafi (2) i kësaj pike, pozitat nga paragrafi (1) i kësaj pike zbriten nga kapitali bazë i institucionit.

25. Pa marrë pëlqimin nga Banka Popullore, institucioni nuk mund të zvogëlojë shumën e mjeteve vetanake përmes:

- riblerjes ose zvogëlimit të vlerës së kapitalit themelor, respektivisht i aksioneve që janë pjesë e kapitalit bazë;
- riblerjes ose shlyerjes së pozicioneve të cilat janë pjesë e kapitalit shtesë.

Banka Popullore do të jap pëlqimin e paragrafit (1) të kësaj pike nëse kanë kaluar së paku pesë vjet nga data e lëshimit/miratimit të instrumentit dhe nëse:

- institucioni e ka zëvendësuar këtë instrument me instrument të ri me cilësi të njejtë ose më të mirë, me koston e zëvendësimit që nuk rrezikon kapacitetin e institucionit për funksionim fitimprurës dhe/ose
- institucioni mund të dëshmojë se mjetet vetanake, pas zvogëlimit të tyre për shkak të aktiviteteve nga paragrafi (1) i kësaj pike, do të jenë mbi nivelin e përcaktuar me Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave.

Për qëllimet e paragrafit (2), nënparagrafin (1) të kësaj pike, kostoja e zëvendësimit nuk kërcënon kapacitetin e institucionit për funksionim fitimprurës nëse kostoja e instrumentit të ri nuk është dukshëm më e lartë se kostoja që ka pasur institucioni për instrumentin që zëvendësohet do t'i mundësojë institucionit të ruajë ose të rrisë rentabilitetin e tij.

Me përjashtim të paragrafit (2) të kësaj pike, Banka Popullore mund të lëshojë pëlqim për riblerjen ose shlyerjen e parakohshme të pozicioneve që janë pjesë e kapitalit shtesë dhe para skadimit të pesë viteve nga data e lëshimit/miratimit të tyre,

vetëm nëse plotësohen kushtet e paragrafit (2) të nënparagrafëve (1) dhe (2) të kësaj pike dhe nëse:

- për shkak të ndryshimeve rregullatore, këto pozicione do të përjashtoheshin nga mjetet vetanake;
- janë bërë ndryshime në trajtimin tatimor të këtyre pozicioneve dhe institucioni mund të vërtetojë se këto janë ndryshime të rëndësishme që nuk mund të parashikoheshin në momentin e dhënies/miratimit të pozicioneve.

Për marrjen e pëlqimit nga paragrafët (2) dhe (4) të kësaj pike, institucioni është i detyruar që së paku tre muaj para zbatimit të aktiviteteve nga paragrafi (1) i kësaj pike, t'i dorëzojë Bankës Popullore së paku:

- arsyetimin e detajuar të arsyeve për zbatimin e aktiviteteve nga paragrafi (1) i kësaj pike;
- strukturën e mjeteve vetanake para dhe pas realizimit të aktiviteteve nga paragrafi (1) i kësaj pike;
- projeksionin e profitabilitetit për tre vitet e ardhshme, duke marrë parasysh koston e zëvendësimit të instrumentit.

VIII. LLOJI, PËRMBAJTJA DHE MËNYRA E DORËZIMIT TË RAPORTEVE TË MJETEVE VETANAKE DERI TE BANKA POPULLORE

26. Institucioni është i detyruar që të plotësojë dhe t'i dorëzojë Bankës Popullore Raport për mjetet vetanake, në të cilin veçmas janë të shënuara pozicionet e kapitalit bazë dhe shtesë dhe artikujt e zbritshëm, të përcaktuara në pajtim me këtë vendim.

Guvernatori i Bankës Popullore me udhëzim e përshkruan Raportin për mjetet vetanake nga paragrafi (1) i kësaj pike.

27. Institucioni përgatit Raportin e mjeteve vetanake sipas gjendjes kontabël në datat 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor dhe ia dorëzon Bankës Popullore.

Afati i dorëzimit të Raportit për mjetet vetanake është pesëmbëdhjetë ditë pune pas përfundimit të periudhës për të cilën është dorëzuar Raporti.

Me kërkesë të Bankës Popullore, institucioni është i detyruar të hartojë Raportin për mjetet vetanake edhe në datë tjetër dhe brenda afati tjetër, të cilat janë të ndryshme nga ato të përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të kësaj pike.

Institucioni i cili është lëndë e mbikëqyrjes së konsoliduar, është i detyruar ti dorëzojë Bankës Popullore Raportin e mjeteve vetanake dhe në bazë të konsoliduar dhe për çdo tjetër institucion i cili kryen shërbime pagesore dhe/ose emeton para elektronike, sipas gjendjes kontabël në datat 30 qershor dhe 31 dhjetor, në afat prej pesëmbëdhjetë ditë pas kalimit të gjysmëvjetorit për të cilin dorëzohet Raporti.

28. Raporti nga pika 27) e këtij vendimi i dorëzohet Bankës Popullore, në formë elektronike, përmes vendimit përkatës aplikativ të Bankës Popullore.

IX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

29. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të zbatohet nga 1 janari 2023.

V. nr. 02-15/XX-3/2022
25 nëntor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryetarja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikën e Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска